

VENDIM
Nr. 65, datë 30.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimimi ,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.11.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (G) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: GENIS MËHILLAJ, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta dhe avokate Entela Memishaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Qerem Hysolako (Lako), përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë të posaçme.

Durim Rodakaj, Agjencia e Trajtimit të Pronës Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Vlorë, Agron Mëhilli, Evelina Mëhilli (Cara), Gëzim Mëhilli, Dilaver Mëhilli, Ismet Mëhilli, Mit'hat Mëhilli, Afërdita Mëhilli, Miroshë Velaj, Fiorina Mëhilli, Riko Mëhilli, Sulltane Lameborshi, Mjaftime Zilja Lameborshi, Drita Mëhilli, trashëgimtarët e Bukurie Mëhillit, Evelina Mehilla (Cara) Dhe Irma Mëhilli (Skënderi), Ermira Mëhilli

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2037, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 956, datë 17.11.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2021-2166, datë 22.12.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDN*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Rajonale Vlorë (*ASHK-ja, Drejtoria Rajonale Vlorë*), e cila nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me çështjen, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesi Genis Mëhillaj është një nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasve Xh. N. dhe M. Mëhilli, të cilëve, me vendimin nr. 38, datë 13.2.2006, të Komitetit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Vlorë (*vendimi nr. 38/2006 i KVKKP-së, qarku Vlorë*), u është njohur pronësia dhe u është kthyer në natyrë një sipërfaqe prej 32.68 hektarësh, të ndodhur në Paska Orikum.

2. Subjekti i interesuar Durim Rodakaj është një prej trashëgimtarëve ligjorë të shtetasve P.R. dhe V.R., të cilëve, me vendimin nr. 219, datë 6.12.1994, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Vlorë (*vendimi nr. 219/1994 i KKKP-së, Bashkia Vlorë*), u është njohur pronësia për tre sipërfaqe toke, në total 101.25 dynym, të ndodhur në Paska Orikum, por u është kthyer në natyrë sipërfaqja 10000 m² (*5000 m² secilit trashëgimlënës bashkëpronarë*). Ky vendim është lëshuar në bazë të dokumenteve arkivore, si dhe vendimit nr. 2506, datë 27.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për vërtetimin e faktit juridik. Ndërsa subjektit tjetër të interesuar Qerem Hysolako (Lako), me vendimin nr. 570, datë 30.3.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, i është njohur pronësia për një sipërfaqe 95900 m², të ndodhur po në Paska Orikum, të trashëguar nga babai i tij, i ndjeri N. H. (Lako).

3. Subjektet e interesuara, Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj, i janë drejtuar gjykatës me padi me objekt anulimin e vendimit nr. 38/2006 të KVKKP-së, qarku Vlorë, për shkak se një pjesë e sipërfaqes së njohur prej tij u është njohur edhe atyre me vendimet nr. 219/1994, të KKKP-së të Bashkisë Vlorë (për paditësin Durim Rodakaj) dhe nr. 570, datë 30.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (për paditësin Qerem Hysolako (Lako)).

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2037, datë 27.7.2009, ka vendosur të pranojë padinë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 38/2006, të KVKKP-së, qarku Vlorë për sipërfaqen e mbivendosur prej 18900 m², që i është njohur paditësit (subjektit të interesuar) Durim Rodakaj me vendimin nr. 2506, datë 27.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe për sipërfaqen e mbivendosur prej 87580 m², që i është njohur paditësit (subjektit të interesuar) Qerem Hysolako (Lako), me vendimin nr. 570, datë 30.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit subjekti i interesuar Durim Rodakaj, i cili ka kërkuar ndryshimin pjesërisht të tij dhe pranimin plotësisht të padisë. Ndaj vendimit të shkallës së parë ka paraqitur ankim edhe pala e paditur në procesin gjyqësor (përfshirë kërkuesin), duke kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 956, datë 17.11.2011, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 2037, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 38/2006, të KVKKP-së, qarku Vlorë që u përket trashëgimlënësve të kërkuesit për sipërfaqen e mbivendosur prej 22190 m², që u është njohur trashëgimlënësve të subjektit të interesuar Qerem Hysolako (Lako) me vendimin gjyqësor nr. 2506, datë 27.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa për pjesët e tjera të vendimit ka vendosur lënien e tij në fuqi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur në proces, përmes përfaqësuesit me prokurë, ndërsa subjektet e interesuara Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj kanë paraqitur kundërrekurs.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin e datës 10.10.2017, fillimisht, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore, ndërsa me vendimin e datës 3.11.2021 ka vendosur revokimin e atij vendimi dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve. Në përfundim, me vendimin nr. 00-2021-2166, datë 22.12.2021, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Në datën 5.4.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.4.2023. Kolegji i Gjykatës, në datën 21.6.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 12.7.2023 ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

8.1.1. *E drejta e aksesit e lidhur me të drejtën për t'u njoftuar për zhvillimin e gjykimit*, pasi gjykimi është zhvilluar në mungesë të një pjese të të paditurve, konkretisht shtetasve M. Z., E. M., I. M. dhe D. M., ndërkohë që vendimet objekt i këtij shqyrtimi kushtetues prekin edhe interesat e këtyre shtetasve. Gjykatat nuk i kanë njoftuar për zhvillimin e gjykimit, me pretendimin se një pjesë ndodheshin jashtë shtetit dhe gjykata e shkallës së parë ka vendosur njoftimin e tyre me shpallje. Nga aktet që u janë bashkëlidhur rekursit të të paditurve, rezulton se këta shtetas kanë qenë brenda territorit të shtetit shqiptar, me adresa të njohura. Kjo parregullsi ka vijuar edhe gjatë gjykimit në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Po kështu, edhe pse kërkuesi është duke vuajtur dënimin e tij me burgim, në zbatim të një vendimi tjetër gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk ka marrë asnjë masë për verifikimin dhe njoftimin e kërkuesit në zbatim të nenit 129 të KPC-së. Vendimi i revokimit të gjykimit në seancë gjyqësore të çështjes parashikon detyrimin që ai t'u komunikohet palëve dhe jo përfaqësuesve të tyre. Gjithsesi, ai vendim i është komunikuar mbrojtësit të kërkuesit në një adresë që nuk ekziston dhe ky i fundit nuk është njoftuar për të. Njoftimi është kryer në Vlorë, ndërkohë që avokati e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë.

8.1.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykatat kanë gjykuar në kolegje të gjykimit të zakonshëm civil një çështje të cilën qartazi e kanë trajtuar si mosmarrëveshje administrative. Gjykatat janë mjaftuar me vlerësimin dhe anulimin e pjesshëm të një akti administrativ, pa u njohur asnjë të drejtë civile palëve që kanë nisur procesin. Në rastin konkret, duke mos u trajtuar në asnjë pjesë e drejta private e paditësve, por vetëm ligjshmëria e aktit administrativ, gjykimi ka natyrë të pastër administrative.

8.1.3. *Parimi i paanshmërisë*, pasi vendimet e gjykatave janë marrë jashtë kuadrit të provave që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe në një interpretim e vlerësim të njëanshëm të tyre. Ato kanë pranuar vlerën provuese të provave për njohjen e pronësisë së paditësve edhe pse janë tërësisht të pamjaftueshme.

8.1.4. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, për shkak se nuk e ka të qartë se në çfarë aspekti do ta trajtojë rekursin e paraqitur, në aspekt të të metave formale, siç është mosnënshkrimi nga ana e mbrojtësit, apo në aspekt të mospërmbushjes së shkaqeve të përcaktuara nga neni 472 i KPC-së. Gjithashtu, në rekurs ishin ngritur pretendime të natyrës kushtetuese që kishin të bënin me mungesën e legjitimitetit të palëve, kompetencën lëndore të gjykatave, cenimin e parimit të paanshmërisë dhe mosnjoftimin e palëve, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë vetëm vlerësime të përgjithshme për këto pretendime. Edhe vendimet e gjykatave të faktit janë mjaftuar me shprehje të përgjithshme, pa bërë një analizë konkrete të pretendimeve, madje duke anashkaluar edhe legjitimitetin e palëve në proces dhe interesin e tyre për të ngritur padi.

8.1.5. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë gjykuar një çështje ku mungon legjitimiteti aktiv dhe interesi për të ngritur padi, pa përjashtuar të gjitha elementet e tjera konstitutive që e bëjnë padinë të papranueshme. Ato nuk janë shprehur për kërkimin kryesor të padisë “ndeshjen e titujve të pronësisë” dhe nuk kanë mbajtur në konsideratë faktin thelbësor se asnjë prej paditësve nuk ka arritur të provojë të drejtën e pronësisë, për rrjedhojë se gëzon të drejtën për të kërkuar rivendosjen e saj. Gjykatat nuk kanë pasur parasysh as vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Lartë nr. 1167, datë 11.10.2007, me të cilin paditësit janë konsideruar si subjekte të treta që kundërshtojnë vendimet e KKKP-ve dhe, si të tillë, duhet të provojnë të drejtën e tyre të pronësisë për të pasur legjitimitet aktiv.

8.1.6. *E drejta e pronës private*, pasi gjykatat nuk kanë kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes. Ato nuk kanë hetuar rreth legjitimitetit aktiv të paditësve në kuadër të konfirmimit të ekzistencës ose ligjshmërisë së titujve të tyre të pronësisë, por e kanë trajtuar çështjen si mosmarrëveshje të

natyrës administrative, ku në themel ka qenë hetimi/kontrolli rreth ligjshmërisë së aktit administrativ. Vendimi nr. 2506, datë 27.9.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është një vërtetim i faktit juridik dhe si i tillë nuk përbën mënyrë të fitimit të pronësisë e nuk regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Kjo mosmarrëveshje ka tërësisht natyrë civile dhe jo administrative. Referuar praktikës së unifikuar të Gjykatës së Lartë, në gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimeve të KKKP-ve, kur kërkimi bëhet nga një person i tretë, që pretendon të ketë fituar pronësinë mbi bazën e një ligji të posaçëm, paditësi legjitimohet vetëm në qoftë se ai provon se është pronari i sendit në fjalë.

9. Subjekti i interesuar, Qerem Hysolako (Lako), në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Kërkesa është e datës 5.4.2023, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 22.12.2021 dhe ai është publikuar në faqen zyrtare të saj, datë nga e cila fillon afati për paraqitjen e ankimit kushtetues.

9.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit* lidhet me mosnjoftimin e shtetasve M. Z., E. M., I. M. dhe D. M., të cilët nuk kanë paraqitur ankim kushtetues, ndaj Gjykata nuk mund të vihet në lëvizje për pretendime që nuk lidhen me kërkuesin, për rrjedhojë ai nuk legjitimohet për këtë pretendim. Për më tepër, rezulton se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet për këtë pretendim, pasi nuk e ka ngritur në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit dhe as në rekursin e bërë në Gjykatën e Lartë. Gjithsesi, njoftimet për këta shtetas janë bërë me shpallje, sipas parashikimeve ligjore. Kurse në lidhje me njoftimin e kërkuesit në Gjykatën e Lartë, sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se avokati i caktuar prej tij është njoftuar për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, nëpërmjet të cilit i është bërë e ditur data dhe ora e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, çështja rezulton se është publikuar dhe në listën e njoftimeve të gjyqësore.

9.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është haptazi i pabazuar, pasi çështja është gjykuar nga gjykata kompetente për shqyrtimin e saj sipas ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*). Kjo është një çështje pronësie dhe kompetente për shqyrtimin e saj janë gjykatat civile dhe jo administrative.

9.4. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi arsyetimi i bërë nga Gjykata e Lartë respekton standardet e vendosura nga Gjykata dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sipas të cilave ajo gjykatë nuk është e detyruar t’i japë përgjigje të detajuar çdo pretendimi të ngritur në rekurs, por vetëm atyre brenda kufijve të gjykimit.

9.5. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata në dhënien e vendimit është mbështetur në provat shkresore të paraqitura gjatë gjykimit.

9.6. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës*, kërkuesi ka paraqitur vetëm koncepte teorike lidhur me natyrën e gjykimit të padisë. Gjithsesi, në gjykim janë paraqitur të gjitha provat shkresore që tregojnë origjinën e pronësisë për secilën palë, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat. Vlerësimi i këtyre provave nuk është në kompetencë të Gjykatës së Lartë dhe nuk është i lidhur me shkaqet e ushtrimit të rekursit.

10. Subjekti i interesuar, Durim Rodakaj, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

10.1. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor. Vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 22.12.2021, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 5.4.2023. Ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe ankuesi ka pasur dijeni për zhvillimin e gjykimit.

10.2. Kërkuesi nuk mund të pretendojë rivendosjen e të drejtave, kur ai nuk ka qenë asnjëherë pronar i ligjshëm i pasurive objekt konflikti gjyqësor. Gjykatat i kanë hequr atij vetëm pjesën e

pronës që ishte marrë në keqzbatim të ligjit, në kundërshtim me dokumentet e pronësisë dhe në tejkalim të kompetencave që ligji i ka dhënë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në këtë kuptim, Gjykata nuk mund të rivendosë një të drejtë që nuk ka ekzistuar asnjëherë.

10.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe asaj për t'u njoftuar për gjykimin është i pabazuar, pasi gjatë gjykimit në gjykatat e faktit kërkuesi nuk ka qenë as në paraburgim, as në burg. Përkundrazi, gjatë gjykimit në ato gjykata ai ka marrë pjesë personalisht në çdo seancë gjyqësore, bashkë me të paditurit e tjerë dhe ata janë përfaqësuar nga avokati. Ky i fundit është njoftuar edhe për revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore. Kërkuesi dhe të paditurit e tjerë janë njoftuar rregullisht nga gjykata sipas parashikimeve ligjore dhe kërkuesi nuk ka sjellë asnjë provë për të mbështetur këtë pretendim.

10.4. Kërkuesit nuk i është cenuar as e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi akti administrativ nr. 38/2006 i KVKKP-së, qarku Vlorë është shpallur absolutisht i pavlefshëm, si i pambështetur në ligj dhe në prova. Gjykatat e kanë rrëzuar kërkesën e paditësve për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

10.5. Pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është i pabazuar. Nga paditësit në gjykim është kërkuar përjashtimi i një anëtarit të trupit gjykues, kërkesë e cila është pranuar. Ndërsa në lidhje me kërkesën e tyre për marrjen e masës provizore të pezullimit, gjykata nuk është shprehur. Ajo është shprehur me vonesë për njohjen pronar të paditësve dhe kjo tregon se gjykata nuk ka qenë e anshme.

10.6. Edhe pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar, pasi vendimet e gjykatave janë arsyetuar sipas standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Gjykatat e kanë mbështetur arsyetimin e tyre në faktet e paraqitura gjatë procesit. Vendimet përmbajnë bazën ligjore në bazë të së cilës është zgjidhur mosmarrëveshja, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe janë logjike, të rregullta në formë dhe në përmbajtje.

10.7. Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi pronësia që kërkuesi pretendon se ka pasur mbi sipërfaqen objekt konflikti gjyqësor është fituar në mënyrë të paligjshme, për shkak se i është njohur 13 vjet më parë subjektit të interesuar Durim Rodakaj me vendimin nr. 219/1994, të KKKP-së së Bashkisë Vlorë.

10.8. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i pabazuar, pasi vendimet e gjykatave janë marrë në respektim të procesit të rregullt dhe të ligjit material e procedural. Gjykatat kanë bërë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, bazuar në provat dhe faktet e paraqitura nga palët, duke u dhënë përgjigje edhe kërkesave të tyre.

11. **Subjekti i interesuar, ASHK-ja, Drejtoria Rajonale Vlorë**, nuk ka paraqitur asnjë argument në kundërshtim të pretendimeve të kërkuesit, por ka sjellë vetëm një informacion në lidhje me veprimet administrative të kryera prej saj në lidhje me pronën objekt i konfliktit gjyqësor.

12. **Subjektet e tjera të interesuara** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo

rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit është subjekt i kushtëzuar dhe mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial.

15. Gjykata vëren se kërkuuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u njoftuar, edhe sepse gjykatat e kanë zhvilluar gjykimin në mungesë të një pjese të të paditurve, konkretisht shtetasve M. Z., E. M., I. M. dhe D. M., interesat e të cilëve preken nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Sipas tij, gjykatat nuk i kanë njoftuar ata për zhvillimin e gjykimit, me pretendimin se një pjesë ndodheshin jashtë shtetit dhe gjykata e shkallës së parë ka vendosur njoftimin me shpallje, ndërkohë që, nga aktet bashkëlidhur rekursit, këta shtetas kanë qenë brenda territorit të shtetit shqiptar, me adresa të njohura. Kjo parregullsi në lidhje me njoftimin e tyre ka vijuar edhe gjatë gjykimit në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë.

16. Subjekti i interesuar, Qerem Hysolako (Lako), ka prapësuar se kërkuuesi nuk legjitimohet për ngritjen e këtij pretendimi, për sa kohë këta shtetas nuk kanë paraqitur ankim kushtetues individual dhe se Gjykata nuk mund të vihet në lëvizje për pretendime që nuk lidhen me kërkuuesin.

17. Në lidhje me këtë pretendim (njoftimin e shtetasve M. Z., E. M., I. M. dhe D. M.) Gjykata vlerëson se kërkuuesi nuk provon interesin e tij të drejtpërdrejtë, pasi nuk ka provuar të drejtën e cenuar dhe interesin e tij të ligjshëm vetjak në këtë drejtim, ndërkohë që përmes këtij pretendimi ai synon mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, që nuk janë pjesë e këtij gjykimi kushtetues. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual, Gjykata vëren se ato lidhen me procesin gjyqësor ku kërkuuesi ka qenë palë, për rrjedhojë ai legjitimohet *ratione personae* për to.

18. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike efektive, subjekti i interesuar Qerem Hysolako (Lako) ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë nuk është ngritur më parë në ankimin në gjykatën e apelit dhe as në rekursin në Gjykatën e Lartë, në këtë mënyrë, kërkuuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në lidhje me të.

19. Jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas shterimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliteve (*shih vendimin nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i përket këtij kriteri legjitimimi (*shterimit të mjeteve*), Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se palët e paditura në proces, ndër të cilat edhe kërkuuesi, kanë nënshkruar prokurën e posaçme nr. 1624 rep. dhe nr. 875/2 kol., datë 17.9.2011, me të cilën i kanë dhënë tagra avokates M. K. “[...] të redaktojë kërkesa, ankesa, rekurse dhe t’i përfaqësojë ato [...]”. Mbi bazën e kësaj prokure, avokatja ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë nëpërmjet rekursit të shkurtuar të datës 13.12.2011. Rezulton, gjithashtu, se në

plotësim të rekursit të shkurtuar në Gjykatën e Lartë ka paraqitur rekurs edhe shtetasi Rr. M., i bashkëpaditur me kërkuesin në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë Gjykatë, dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 6.12.2012.

21. Gjykata vëren se sipas nenit 162, paragrafi i dytë, i KPC-së, kur për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike që janë në konflikt, efekti i vendimit që do të jepet shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt edhe për bashkëndërgjyqësit e tjerë. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se kërkuesi dhe shtetasi Rr. M. tërheqin interesa të njëjtë, për shkak se janë e njëjta palë ndërgjyqëse dhe kanë të njëjtin qëllim, prandaj rekursi i paraqitur nga shtetasi Rr. M., në kuptim të nenit 162 të KPC-së, konsiderohet se është rekurs edhe i kërkuesit. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata çmon se plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve, për sa kohë që kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.¹

22. Për sa u përket pretendimeve të paraqitura në ankimin kushtetues, rezulton se ai për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, nuk është ngritur nga kërkuesi as në ankim ose rekurs, as para atyre gjykatave gjatë gjykimit të çështjes, por ngrihet për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë aspekt të procesit gjyqësor të zhvilluar në ato gjykata, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive. Kurse për sa i përket këtij pretendimi, në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk ka pasur mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues.

23. Për sa u përket pretendimeve të tjera që kanë të bëjnë me procesin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, përfshirë atë për cenimin e së drejtës së aksesit, Gjykata vëren se ato janë ngritur në substancë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke u plotësuar kështu kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

24. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, subjektet e interesuara Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj kanë pretenduar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Sipas tyre, vendimi i fundit i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.12.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 5.4.2023. Kërkuesi ka pasur dijeni për zhvillimin e gjykimit dhe vendimi rezulton se është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, datë nga e cila fillon afati për paraqitjen e ankimit kushtetues.

25. Sipas kërkuesit, ai ka qenë duke vuajtur dënimin me burgim në zbatim të një vendimi penal dhe nuk është njoftuar as për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimit të nenit 129 të KPC-së, as për vendimin e saj. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë i është njoftuar bashkëshortes në datën 6.12.2022, pas kërkesës së bërë nga kjo e fundit për t’u pajisur me një kopje të vendimit. Në këto kushte, afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues fillon nga kjo datë, kur bashkëshortja e tij është njohur efektivisht me përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar.

26. Gjykata vëren se sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Ajo ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i

¹ Gjyqtarët Fiona Papajorgji, Elsa Toska dhe Ilir Toska votuan kundër për kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, për shkak se kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, rezulton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 22.12.2021, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar në Gjykatë nga përfaqësuesi i kërkuarit në datën 5.4.2023, pra pas rreth 16 muajsh nga ajo datë.

28. Gjykata vëren se gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë kërkuar ndodhej në kushtet e kufizimit të lirisë personale për efekt të vuajtjes së dënimit penal të dhënë ndaj tij me vendimet nr. 99, datë 14.7.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe nr. 14, datë 9.3.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Gjithashtu, Gjykata konstaton se sipas shkresës nr. B-100/1 prot., datë 24.1.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kërkuar aktualisht është duke kryer dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Fier.

29. Në lidhje me procedurën e ndjekur nga Gjykata e Lartë për njoftimin e palëve, Gjykata vëren se referuar të dhënave të faqes zyrtare të saj, çështja e kërkuarit është shpallur në rubrikën “Çështje për gjykim” dhe mënyra e disponimit të saj, për mospranimin e rekursit, është njoftuar në rubrikën “Informacion mbi çështjet civile për shqyrtim në dhomë këshillimi të datës 22 dhjetor 2021”. Gjykata vëren, gjithashtu, se bashkëshortja e kërkuarit në datën 23.11.2022 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për t’u pajisur me kopje të vendimit të asaj gjykate, në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. 6381/1 prot., datë 6.12.2022, të asaj gjykate, i është vënë në dispozicion vendimi objekt i ankimit kushtetues individual.

30. Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata, me shkresën nr. 3244/1 prot., datë 13.6.2023, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi i plotë dhe i arsyetuar është bërë i disponueshëm për palët në datën 8.2.2022 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të asaj gjykate në datën 9.2.2022.

31. Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se kërkuar ka qenë i izoluar pranë IEVP-së, rrethanë kjo që sipas jurisprudencës kushtetuese vështirëson marrjen dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga njoftimi me shpallje (*shih vendimet nr. 45, datë 3.10.2023; nr. 14, datë 21.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), si moment i njohjes efektivisht me vendimin, pra si moment i konstatimit të cenimit, do të konsiderohet data 6.12.2022, në të cilën Gjykata e Lartë, përmes shkresës nr. 6381/1 prot., datë 6.12.2022, i ka vënë në dispozicion kopje të vendimit të arsyetuar të asaj gjykate. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë datë si ajo nga e cila fillon të llogaritet afati 4-mujor, Gjykata vlerëson se kërkuar legjitimohet edhe *ratione temporis*.

32. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuar ka pretenduar cenimin e *parimit të paanshmërisë*, duke parashtruar si argumente se vendimet e gjykatave janë marrë jashtë kuadrit të provave që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe në një vlerësim të njëanshëm të tyre; gjykatat kanë pranuar vlerën provuese të provave për njohjen e pronësisë së paditësve edhe pse ato janë tërësisht të pamjaftueshme në këtë drejtim; provat janë interpretuar nga gjykata në mënyrë tërësisht të njëanshme, pa kryer asnjë hetim të mëtijshëm.

33. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuarit (cenimin e parimit të paanshmërisë), Gjykata konstaton se ai nuk ka sjellë asnjë argument kushtetues në verifikimin e testit *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe në

verifikimin e testit *objektiv*, nëpërmjet të cilit shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Për këtë arsye, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

34. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së pronës private* dhe të *parimit të sigurisë juridike*, duke parashtruar se: gjykatat kanë legjitimuar paditësit pa verifikuar më parë pronësinë e tyre për pasuritë objekt të vendimit të KKKP-ve, të kundërshtuar në procesin gjyqësor; vendimi nr. 2506, datë 27.9.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vërtetim i faktit juridik dhe, si i tillë, nuk përbën mënyrë të fitimit të pronësisë e nuk regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme; gjykatat kanë gjykuar një çështje ku mungon legjitimimi aktiv dhe interesi për të ngritur padi; ato nuk janë shprehur për kërkimin kryesor të padisë “ndeshjen e titujve të pronësisë”; gjykatat nuk kanë mbajtur në konsideratë faktin thelbësor se asnjë prej palëve paditëse nuk ka arritur të provojë të drejtën e pronësisë për pasurinë objekt gjykimi, për rrjedhojë të gëzojë të drejtën t’i drejtohet gjykatës për rivendosjen e saj; ato nuk kanë pasur parasysh vendimin e ndërmjetëm nr. 1167, datë 11.10.2007, të Gjykatës së Lartë, me anë të të cilit paditësit janë konsideruar si subjekte të treta që kundërshtojnë vendimet e KKKP-ve dhe, si të tilla, duhet të provojnë të drejtën e pronësisë për të pasur legjitimitet aktiv.

35. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 42, datë 19.9.2023; nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se për të mbështetur pretendimet e tij për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* dhe të *drejtës së pronës*, kërkuari, në thelb, ka ngritur argumente në lidhje me verifikimin nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për legjitimitetin e paditësve, që nga për nga natyra e tyre kanë të bëjnë thelbësisht me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga ato gjykata. Në këtë kuptim, në kushtet kur kërkuari nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës se si kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, këto pretendime mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues e nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

37. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në kërkesë, konkretisht ato për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nga Gjykata e Lartë, së drejtës për t’u njoftuar për gjykimin në po atë gjykatë, si edhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ato, *prima facie*, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

38. Kërkuari ka pretenduar se çështja e tij ka natyrë administrative, edhe pse në gjykimin në fakt është shqyrtuar nga kolegjet civile, për rrjedhojë duhej të gjykohej nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

39. Subjekti i interesuar, Qerem Hysolako (Lako) ka prapësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar, pasi çështja është gjykuar nga gjykata kompetente për shqyrtimin e saj, sipas ligjit nr. 133/2015. Sipas

tij, kjo është një çështje pronësie dhe kompetente për shqyrtimin e saj janë gjykatat civile dhe jo administrative.

40. Sipas subjektit të interesuar, Durim Rodakaj, ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar, pasi akti administrativ nr. 38/2006 i KVKKP-së, qarku Vlorë, është shpallur absolutisht i pavlefshëm, i pambështetur në ligj dhe në prova. Sipas tij, gjykatat e kanë rrëzuar kërkesën e paditësve për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

41. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *“gjykatë e caktuar me ligj”*. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 14.9.2023; nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Një nga elementet e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është edhe kompetenca lëndore e gjykatës, e cila me ligj është kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë parim, ligji ka parashikuar verifikimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë të vetë gjykatës, së cilës i paraqitet kërkesëpadia, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur. Thelbësore në përcaktimin e kompetencës lëndore është identifikimi i natyrës së mosmarrëveshjes, konkretisht objekti dhe shkak ligjor i saj (*shih vendimin nr. 3, datë 7.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Për t’i dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuarit, Gjykata vlerëson që për përcaktimin e kompetencës lëndore t’i referohet pikërisht identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes që është shtruar për gjykim, pra nëse ajo është e natyrës civile apo administrative.

44. Gjykata vëren se kompetenca lëndore e gjykatave administrative është përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, sipas të cilit ato janë kompetente për mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike; mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik; mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative; mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës së nëpunësve civilë. Ndërsa sipas nenit 41 të KPC-së, në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë kod e në ligje të tjera. Kompetenca përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit ose të ligjit.

45. Gjykata konstaton se sipas vendimit unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykatat administrative të të gjitha niveleve, të krijuara me ligjin nr. 49/2012, janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013 dhe deri në këtë datë shqyrtimi në gjykata nuk ka përfunduar ende. Ndërsa sipas vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 4/2013*), shqyrtimi i mosmarrëveshjeve me objekt kundërshtimin e vendimeve të KKKP-ve mund të bëhet vetëm nga gjykatat e zakonshme civile, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe të KPC-së. Për këto arsye, çështje të këtij lloji do të konsiderohen si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohen nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile.

46. Në rastin konkret, Gjykata vëren se objekt i mosmarrëveshjes konkrete është vendimi nr. 38/2006 i KVKKP-së, qarku Vlorë. Kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në vitin 2009 dhe Gjykata e Apelit Vlorë në vitin 2011 (para miratimit të ligjit nr. 49/2012), të cilat në përfundim të gjykimit kanë vendosur pranimin e padisë dhe anulimin pjesërisht të vendimit të KVKKP-së, qarku Vlorë. Mbi bazën e rekursit të të paditurve kjo çështje është

regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 6.12.2012, në kategorinë e çështjeve civile dhe është shqyrtuar nga Kolegji Civil i asaj gjykate, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

47. Për sa më sipër, duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 41 të KPC-së, si dhe në mbështetje të vendimit unifikues nr. 4/2013, që ka shpjeguar ndarjen e kompetencës midis gjykatave administrative dhe atyre civile, referuar objektit të mosmarrëveshjes konkrete, Gjykata vëren se ajo ka natyrë civile, për rrjedhojë kompetente për shqyrtimin e saj është Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, në kushtet që në kohën e shqyrtimit të çështjes Kolegji Civil ka qenë kompetent nga pikëpamja lëndore, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar

48. Kërkuari ka pretenduar se ai është duke vuajtur dënimin me burgim, në zbatim të një vendimi penal, dhe Gjykata e Lartë nuk ka marrë asnjë masë për verifikimin dhe njoftimin e kërkuarit në zbatim të nenit 129 të KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur, fillimisht, gjykimin në seancë gjyqësore me praninë e palëve, por më pas e ka revokuar këtë vendim, duke gjykuar çështjen në mungesë të plotë të palëve dhe mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre të ligjshëm. Vendimi i revokimit të gjykimit në seancë gjyqësore të çështjes parashikon detyrimin që t'u komunikohet palëve dhe jo përfaqësuesve të tyre. Gjithsesi, ai vendim i është komunikuar mbrojtësit të kërkuarit në një adresë që nuk ekziston dhe ky i fundit nuk është njoftuar për të. Njoftimi është kryer në Vlorë, ndërkohë që avokati e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë.

49. Subjektet e interesuara, Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj, kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi sipas akteve të dosjes gjyqësore avokati i caktuar është njoftuar për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, nëpërmjet të cilit i janë bërë të ditura data dhe ora e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, çështja është publikuar edhe në listën e njoftimeve të gjytimeve.

50. Gjykata ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 42, datë 19.9.2023; nr. 29, datë 26.5.2023; nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Sipas nenit 482, pika 3, të KPC-së, sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Ndërsa, sipas nenit 129, pika 3, të KPC-së, kur pala është nën masë paraburgosë ose vuan dënimin me burgim, gjykata kryen njoftimin në vendin e ekzekutimit të masës ose dënimit, duke urdhëruar organet përkatëse që ta shoqërojnë në gjykatë, kur pala kërkon të marrë pjesë personalisht në gjykim. Në këto raste, gjykata përsërit njoftimin për personin për çdo seancë, përveç rastit kur ai kërkon të vazhdojë gjykimin në mungesë.

52. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se palët e paditura në proces, ndër të cilat dhe kërkuari, pas nënshkrimit të prokurës me të cilën i kanë dhënë tagra mbrojtësit të tyre për redaktimin e rekursit (*shih paragrafin 20 më sipër*), në datën 25.1.2013, kanë nënshkruar prokurën tjetër të posaçme, nr. 119 rep. dhe nr.

69/1 kol., nëpërmjet së cilës i kanë dhënë tagra përfaqësimi avokatit P. K. për t'i përfaqësuar në Gjykatën e Lartë.

53. Në datën 10.10.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin, ka vlerësuar se ai përmbush kriteret e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, ndaj ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim. Në datën 16.11.2017, sipas procesverbalit të seancës gjyqësore, Kolegji Civil ka çelur seancën gjyqësore dhe ka verifikuar praninë e palëve, seancë në të cilën ka qenë i pranishëm edhe avokati P. K. Palëve të pranishme në seancë u është bërë me dije se trupi gjykues nuk është formuar, pasi ishte i përbërë vetëm nga dy anëtarë. Kolegji Civil ka vërejtur se nga pala paditëse (subjektet e interesuara) ishte paraqitur një kërkesë për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe e këshilluar në vend ka vendosur të njoftojë palët nëse do të pranohej kjo kërkesë, duke deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe duke shtyrë seancën gjyqësore e njoftimin e saj me shpallje (*shih faqet 35–36 të dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë*).

54. Në vijim, me ndryshimin e përbërjes së Gjykatës së Lartë është caktuar gjyqtari i ri relator për këtë çështje dhe përbërja e trupit gjykues të Kolegjit Civil. Me vendimin e datës 3.11.2021 (*vendimi i revokimit*), Kolegji Civil ka vendosur revokimin e vendimit të datës 10.10.2017, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke e kthyer çështjen për shqyrtim në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve dhe duke urdhëruar sekretarinë e Gjykatës së Lartë për njoftimin e palëve për orën dhe ditën e shqyrtimit në dhomën e këshillimit, si dhe të drejtën për paraqitjen, brenda 15 ditëve, të parashtrimeve me shkrim.

55. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, konstaton se njoftimi i vendimit të revokimit i është dërguar avokatit P.K. në Dhomën e Avokatisë Vlorë në datën 9.11.2021, nga i cili rezulton shënimi i shërbimit postar “*kthehet - i panjohur*”. Ndërkohë që referuar prokurës së posaçme të nënshkruar nga paditësit, për përfaqësimin në Gjykatë të Lartë nga avokati P.K., të administruar në dosjen gjyqësore, ky i fundit rezulton të jetë anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë verifikuar adresën e saktë të mbrojtësit të kërkuarit, me qëllim komunikimin e vendimit të revokimit, duke qenë se kjo e fundit rezultonte edhe nga aktet gjyqësore (prokura nr. 119 rep., nr. 69/1 kol., datë 25.1.2013), për më tepër kur për çështjen konkrete ishte zhvilluar një seancë gjyqësore.

56. Gjykata konstaton, gjithashtu, se vendimi i revokimit nuk rezulton t'i jetë komunikuar as kërkuarit. Gjykata e Lartë në datën 3.11.2021, ka shpallur datën 22.12.2021, për shqyrtimin e çështjes së kërkuarit në dhomën e këshillimit, në faqen zyrtare dhe ambientet e saj. Në këto kushte, edhe pse Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me nenin 482 të KPC-së, dhe kërkuari nuk ka provuar se avokatët kishin lënë të dhënat e kontaktit, mungesa e njoftimit për vendimin e revokimit e ka vënë atë në pamundësi të realizojë mbrojtjen duke paraqitur prapësimet në lidhje me shkaqet e rekursit. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh edhe gjendjen e kërkuarit, i cili është në kushtet e kufizimit të lirisë, për shkak të ekzekutimit të vendimit të gjykatës penale, të dhënë në ngarkim të tij, Gjykata çmon se mungesa e këtij njoftimi përbën mangësi në mënyrën e njoftimit të palëve, e cila rezulton ta ketë vendosur kërkuarin në pozita të pafavorshme në krahasim me palën tjetër në proces.

57. Po kështu, në kushtet kur kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë (regjistruar në datën 6.12.2012, ndërkohë që gjykimi ka përfunduar në datën 22.12.2022), njoftimi i vendimit të revokimit, në të cilin palët janë njoftuar edhe për zhvillimin e seancës në atë gjykatë, merrte rëndësi të veçantë për ecurinë e mëtejshme të gjykimit dhe për garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Nëse kërkuari do të ishte vënë në dijeni të këtij fakti, do të kishte marrë masat e nevojshme që prapësimet e tij për kundërrekursin e paraqitura nga subjektet e interesuara Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj t'i paraqiste në Gjykatën e Lartë, duke realizuar kështu dhe të drejtën e tij të mbrojtjes.

58. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar është i bazuar.

59. Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, i cili bazohet në argumentin se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor lidhur me shkakun e mospranimit, në kushtet kur çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e tij.

60. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, ndërsa pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me atë për t'u dëgjuar, për shkak të mosnjohimit të vendimit të revokimit dhe datës së seancës gjyqësore, është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-2166, datë 22.12.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.11.2023.

Shpallur më 4.1.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 3 (G) 2023, që i përket kërkuarit Genis Mëhillaj, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 2037, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 956, datë 17.11.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2021-2166, datë 22.12.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësojmë se duhet të ishte vendosur rrëzimi i saj.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e kësaj çështjeje, rezulton se subjektet e interesuara Qerem Hysolako (Lako) dhe Durim Rodakaj kanë vënë në lëvizje një proces gjyqësor, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 38, datë 13.2.2006, të Komitetit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Vlorë (*vendimi nr. 38/2006 i KVKKP-së, qarku Vlorë*), dhënë në favor të subjekteve të shpronësuar, vëllezërve Xhevit, Namik dhe Merko Mëhilli. Të paditur në gjykim janë thirrur 17 trashëgimtarët e tyre, ndër ata edhe kërkuari. Këta të paditur, me përjashtim të tre prej tyre, janë përfaqësuar në gjykim nga avokati I.D. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2037, datë 27.7.2009, ka vendosur të pranojë padinë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 38/2006 të KVKKP-së, qarku Vlorë. Kundër këtij

vendimi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit subjekti i interesuar Durim Rodakaj, i cili ka kërkuar ndryshimin pjesërisht të vendimit dhe pranimin plotësisht të padisë në lidhje me pretendimet e tij. Po ashtu, ka paraqitur ankim edhe avokati i të paditurve Mëhilli, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së dy subjekteve të interesuara.

3. Në gjykimin e çështjes në apel të gjithë të paditurit Mëhilli janë përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokatja M. K. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 956, datë 17.11.2011, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar ankimin e subjektit të interesuar Durim Rodakaj. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin për pjesën tjetër në lidhje me subjektin e interesuar Qerem Hysolako (Lako). Në këtë mënyrë ajo nuk ka pranuar ankimin e të paditurve Mëhilli.

4. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 13.12.2011, avokatja M. K, si përfaqësuese e të paditurve Mëhilli, ka depozituar rekurs, në të cilin ka parashtruar se për shkak të vonesës së arsyetimit të vendimit nga gjykata e apelit, shkaqet e plota të rekursit do të paraqiteshin pas njohjes me të. Në vijim, në datën 6.3.2012 është depozituar rekurs i plotë kundër vendimit të gjykatës së apelit nga një prej të paditurve Mëhilli, konkretisht shtetasi Rr. M. Paditësit kanë paraqitur kundërrkurs, duke kërkuar mospranimin e rekursit. Më pas dosja gjyqësore i është dërguar Gjykatës së Lartë.

5. Ndërsa çështja ndodhej në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, të paditurit Mëhilli kanë zgjedhur me prokurë të posaçme një avokat tjetër (P. K.). Fillimisht, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (kolegji seleksionues), me vendimin datë 10.10.2017, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim (në seancë gjyqësore me praninë e palëve), ndërsa më pas, me vendimin e datës 3.11.2021, ai ka revokuar vendimin e mëparshëm duke e kthyer çështjen për shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë të dokumenteve. Në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 00-2021-2166, datë 22.12.2021, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Në arsyetimin e vendimit parashtrohen dy argumente për mospranimin e rekursit dhe konkretisht: *i.* ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC); *ii.* ai nuk plotëson kushtet ligjore për t'u marrë në shqyrtim, kjo referuar faktit se në datën 13.12.2011 është depozituar rekurs për zënie afati, i nënshkruar nga avokatja M.K me prokurë të posaçme, ndërsa në datën 6.3.2012, është depozituar rekursi me shkaqe, i cili është nënshkruar nga shtetasi Rr.M, por se bashkëlidhur këtij rekursi nuk ka akt përfaqësimi për dy avokatët (E. D dhe A. S) të shënuar në kokën e rekursit dhe as për shtetasin që e ka nënshkruar atë (*shih paragrafët 24, 25 dhe 26, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

6. Në ankimin e tij kushtetues kërkuar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt* në drejtim të: *1. së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar për zhvillimin e gjykimit*, pasi gjykatat kanë zhvilluar gjykimin në mungesë të disa prej të paditurve Mëhilli (M. Z., E. M., I. M. dhe D. M.), pa i njoftuar ata në adresat e tyre të banimit, ndërkohë që vendimet e gjykatave prekin edhe interesat e tyre. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë (kërkuesin) sipas nenit 129 të KPC-së në lidhje me vendimin e revokimit të gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore, përveçse ky vendim nuk i është komunikuar as avokatit P. K., caktuar me prokurë të posaçme nga të paditurit Mëhilli; *2. së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi megjithëse çështja në të tria gjykatat është shqyrtuar në kolegjet civile të tyre, mosmarrëveshja është trajtuar si e natyrës administrative; *3. parimit të paanshmërisë*, pasi vendimet e gjykatave janë marrë jashtë kuadrit të provave që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe në një interpretim e vlerësim të njëanshëm të tyre; *4. standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, duke mos qenë e qartë se në çfarë aspekti e ka trajtuar rekursin e paraqitur, në atë të të metave formale, siç është mosnënshkrimi nga ana e mbrojtësit, apo në atë të mospërmbushjes së shkaqeve të përcaktuara nga neni 472 i KPC-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka bërë vlerësime të përgjithshme në lidhje me pretendimet me natyrë kushtetuese të

ngritura në rekurs, konkretisht për ato që kishin të bënin me mungesën e legjitimitetit të paditësve, me kompetencën lëndore të gjykatave, me cenimin e parimit të paanshmërisë, me mosnjohimin e palëve. Edhe vendimet e gjykatave të faktit janë mjaftuar me shprehje të përgjithshme dhe pa bërë një analizë konkrete të pretendimeve, madje duke anashkaluar legjitimitetin e paditësve në proces dhe interesin e tyre për të ngritur padi; 5. *parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë gjykuar një çështje ku paditësve iu mungon legjitimiteti aktiv dhe interesi për të ngritur padi, pa përjashtuar të gjitha elementet e tjera konstitutive që e bëjnë padinë të papranueshme, duke mos mbajtur në konsideratë faktin thelbësor se asnjë prej paditësve nuk ka arritur të provojë të drejtën e pronësisë. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar *e drejta e pronës private*, pasi gjykatat nuk kanë kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes, duke mos hetuar rreth legjitimitetit aktiv të paditësve në kuadër të konfirmimit të ekzistencës apo ligjshmërisë së titujve të tyre të pronësisë, por e kanë trajtuar çështjen si mosmarrëveshje të natyrës administrative, ku në themel ka qenë hetimi/kontrolli rreth ligjshmërisë së aktit administrativ.

7. Shumica në analizë të kriterëve të legjitimitetit ka vlerësuar se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, përveç pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar për zhvillimin e gjykimit (*shih paragrafin 17 të vendimit*). Gjithashtu, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, sikundër edhe *ratione materiae* për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u njoftuar, si edhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafin 37 të vendimit*). Ndërkohë, për pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë, së drejtës së pronës private dhe të parimit të sigurisë juridike, shumica ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* (*shih paragrafët 33 dhe 36 të vendimit*). Në përfundim të analizës së saj, shumica ka vlerësuar të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar nga Gjykata e Lartë, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të saj dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim (*shih paragrafët 48-58 të vendimit*). Ndërkohë, shumica ka gjetur të pabazuar pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih paragrafët 38-47 të vendimit*), ndërsa pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, ka vlerësuar të mos e trajtojë në kushtet kur çështja do të rishqyrtohet nga ajo gjykatë (*shih paragrafin 59 të vendimit*).

8. Ndërsa sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesi e plotëson këtë kriter. Lidhur me këtë, ndërsa ka pranuar se rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur nga i bashkëpadituri Rr. M., shumica ka arsyetuar se duke qenë se kërkuesi dhe shtetasi Rr. M. tërheqin interesa të njëjta, për shkak se janë e njëjta palë ndërgjyqëse dhe kanë pasur të njëjtin qëllim, rekursi i paraqitur nga shtetasi Rr. M., në kuptim të nenit 162 të KPC-së, konsiderohet se është rekurs edhe i kërkuesit. Sipas shumicës, duke mbajtur në konsideratë edhe respektimin e procesit të rregullt ligjor, në zbatimin e këtij kriteri ajo duhet të tregohet fleksibël dhe pa formalizma të tepëra, për sa kohë efektet juridike të vendimit të Gjykatës së Lartë shtrihen edhe ndaj kërkuesit, ndaj ai plotëson kriterin e shterimit të mjeteve, duke qenë se ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta (*shih paragrafin 21 të vendimit*). Nga ana tjetër, shumica ka konsideruar se kërkuesi nuk plotëson këtë kriter vetëm në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, për sa kohë një pretendim i tillë nuk është ngritur as në ankim ose rekurs dhe as para atyre gjykatave gjatë gjykimit të çështjes, por ngrihet për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Kurse për sa i përket këtij pretendimi në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, sipas shumicës, kërkuesi nuk ka pasur mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

9. Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive. Ashtu sikurse pranon shumica, individi mund t'i drejtohet Gjykatës pasi ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, çka nënkupton se duhet t'i jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 54, datë 24.7.2017; nr. 6, datë 4.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret kërkuesi nuk e plotëson këtë kriter për sa kohë rezulton se ai nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Ky ka qenë qëndrimi i mbajtur në mënyrë konstante në jurisprudencën e Gjykatës, prandaj arsyetimi i shumicës në këtë drejtim është i sforcuar, duke u mbështetur në një interpretim të ligjit procedural civil (nenit 162 të KPC-së), çka jo vetëm del përtej rolit të Gjykatës, por edhe interpretimi i bërë nuk duket që i përgjigjet qëllimit të normës. Në çështjen në shqyrtim jemi para bashkëndërgjyqësisë dhe, në veçanti, para asaj pasive, duke qenë se kemi disa të paditur. Po ashtu, bashkëndërgjyqësia pasive e të paditurve Mëhilli është e detyrueshme, sa kohë në gjykim faktet nuk tregojnë ekzistencën e disa marrëdhënieve materiale. Gjithsesi, vetëm kjo rrethanë nuk mund të interpretohet se akti i rekursit i një prej të paditurve Mëhilli është një akt i të gjithë atyre, përfshirë edhe i kërkuetit.

11. Në ndryshim nga shumica, jemi të mendimit se rregullat e institutit të bashkëndërgjyqësisë kanë dy qëllime, ekonominë e gjykimit dhe sigurinë juridike, ku pikërisht referuar këtyre qëllimeve duhet interpretuar edhe përcaktimi i bërë në nenin 162, paragrafi i dytë, të KPC-së, sipas të cilit kur, për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike që janë në konflikt, efekti i vendimit që do të jepet shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt edhe për bashkëndërgjyqësit e tjerë që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar. Një përcaktim i tillë do të thotë se veprimi procedural i një bashkëndërgjyqësi është i aftë të sjellë dobi ose dëm edhe ndaj bashkëndërgjyqësve të tjerë, por jo se veprimi i tij procedural konsiderohet si i kryer nga të gjithë ata. Vlen të përmendet po ashtu se ankimi në përgjithësi është një akt personal vullneti, duke mos pasur rëndësi qëllimi i ankuesit në arritjen e pasojave të caktuara për të gjithë bashkëndërgjyqësit, të cilat, në fakt, janë të paracaktuara nga ligji. Me fjalë të tjera, qëllimi i ankuesit për të arritur në marrjen e një vendimi nga gjykata në favor të të gjithë bashkëndërgjyqësve, sikundër edhe shtrirja e efekteve të vendimit të saj për të gjithë këta të fundit, nuk nënkupton se ankues janë të gjithë ata. Për këtë arsye ligji procedural civil ka rregulluar qartë mjetet e ankimit dhe formën e tyre, ku në çdo rast ankimi gjyqësor bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet.

12. Për sa më lart, në rrethanat kur kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, vlerësojmë se ankimi kushtetues individual i tij nuk plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, prandaj Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës për këtë shkak kushtetues.

Anëtarë: Ilir Toska, Elsa Toska Fiona Papajorgji